



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

Raport Inspektimi Nr: 6/2015

**VLERËSIMI I MENAXHIMIT TË PUNËS NË
DREJTORINË PËR MIGRIM DHE TË HUAJ**



(2015)

Aprovuar
Fitim Shishani
Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së

SHKURTESAT

PK	Policia e Kosovës
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
DI	Departamenti i Inspektiveve
UA	Udhëzimi Administrativ
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
DMH	Drejtoria për Migrim dhe të Huaj
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
BMS	Border Menaging System
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës

P Ë R M B A J T J A

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE (4-5)
2. HYRJE (6-7)
3. ORGANIZIMI DHE STRUKTURA NË DREJTORINË PËR MIGRIM DHE TË HUAJ.....(8-8)
4. VLERËSIMI DHE IDENTIFIKIMI I RREGULLATIVËS LIGJORE NË DREJTORINË PËR MIGRIM DHE TË HUAJ.....(9-10)
5. VLERËSIMI I MIRËMBAJTJES DHE RIFRESKIMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE TË DREJTORISË PËR MIGRIM DHE TË HUAJ DHE DOSJEVE TË RASTEVE.....(11-13)
6. VLERËSIMI I EFIKASITETIT TË PUNËS INSPEKTUESE TË DREJTORISË PËR MIGRIM DHE TË HUAJ SI DHE KOMUNIKIMIT DHE ADRESIMIT TË TË GJETURAVE TË INSPEKTIMIT(14-18)
7. PËRFUNDIMET (19-20)
8. REKOMANDIMET (21-21)
9. PLANI I VEPRIMIT TË PK-së PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE TË IPK-së.....(22-22)

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1. Në bazë të nenit 24, paragrafi 2, të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), IPK-ja ka zhvilluar një inspektim të jashtëzakonshëm në Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Departamentit të Policisë Kufitare të PK-së lidhur me **“Vlerësimin e menaxhimit të Punës së DMH-së”**. Me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, ky inspektim është zhvilluar për të vlerësuar kryerjen e detyrave nga zyrtarët policor në përputhje me rregullat dhe autorizimet ligjore në fuqi.

1.2. Inspektimit në këtë fushë i ka paraprirë, hartimi i programit inspektues duke përfshirë edhe përzgjedhjen e metodologjisë së punës. Programi inspektues ka paraparë fillimin e aktivitetit inspektues në terren më datë 15.09.2015 deri me datë 05.10.2015 dhe zhvillohet në bazë të protokollit zyrtar të inspektimit, i cili përmban orarin dhe listën e intervistave.

1.3. Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës në këtë fushë bëhet për të siguruar llogaridhënie, efikasitet dhe efektivitet në implementimin e ligjeve të aplikueshme, akteve nënligjore dhe procedurave tjera standarde të operimit në fuqi si dhe për ngritjen e performancës së zyrtarëve policor në DMH. Ky raport i inspektimit përfshinë të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna për përmirësimin e gjendjes së gjetur.

1.4. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se infrastruktura ligjore e cila e mbulon punën e DMH-së, është mjaft mirë e kompletuar si në nivelin Ligjeve ashtu edhe në nivelin Udhëzimeve Administrative. Por e njëjta nuk vlen edhe për nivelin Procedurave Standarde të Operimit, pasi që të gjeturat e inspektimit tregojnë se ende nuk janë azhurnuar Procedurat Standarde të Operimit për dy sektorët të cilët janë në kuadër të DMH-së. Gjithashtu të gjeturat e inspektimit tregojnë se struktura organizative e DMH-së nuk është e plotësuar me numrin e nevojshëm të personelit, sidomos me personelin mbikëqyrës, pasi që të pa plotësuar janë dy pozitat udhëheqëse në sektorin e kontrollit. Mungesa e personelit mbikëqyrës si dhe mos azhurnimi i PSO-ve ndikon drejtpërdrejt në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të kësaj drejtorie.

1.5. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se DMH nuk ka një Bazë të të dhënave unike në të cilën do të regjistroheshin apo evidentoheshin të gjitha aktivitetet e kësaj drejtorie, por që evidentimi i aktiviteteve bëhet në bazat e të dhënave të adaptuara (regjistrat) për secilin aktivitet veç e veç. Këto baza të të dhënave (të adaptuara) janë të hartuar nga zyrtarët policor në programin aplikativ EXEL.

1.6. Kontrollimi i dosjeve fizike të vendimeve për shqiptimin e gjobave, ka rezultuar me të gjeturat se në disa raste këto dosje nuk janë kompletuar konform Procedurës Standarde të Operimit për Zbatimin e Dispozitave Ndëshkimore nga Ligji për të Huaj. Ku, në disa dosje fizike nuk ishin të vendosura kopjet e dokumenteve si: dëshmia e sekuestrimit të dokumentit të identifikimit, raporti i inspektimit etj. Gjithashtu të gjeturat e inspektimit tregojnë, se DMH është mjaft shumë e angazhuar në kontrollin për qëndrimin e të huajve në Republikën e Kosovës, duke kryer 821 inspektime gjatë periudhës kohore 01.01.2015 deri më 30.06.2015. Mirëpo, raportet nga këto inspektime nuk ishin në nivelin e kënaqshëm sa i përket paraqitjes së të gjeturave, pasi që në to nuk janë paraqitur informacionet sa i përket vendbanimit të personave të huaj apo kishte edhe gabime gjatë prezantimit të të gjeturave në raport.

1.7. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se Policia e Kosovës, kishte ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj personave të huaj të cilët në një mënyrë apo tjetër kishin ra ndesh me

rregullat e përcaktuara me ligjin për të huaj. Krahas shqiptimit të masës ndëshkuese me gjobë, të gjeturat e inspektimit tregojnë se ishin shqiptuar edhe masat si urdhër largimet, ndërprerja e leje qëndrimit afat shkurtër si dhe ndalesa për hyrje në territorin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu të gjeturat e inspektimit tregojnë se ka raste kur nuk ndërmerret asnjë masë ndëshkuese ndaj këtyre personave të cilët kanë rënë ndesh me ligjin për të huaj.

1.8. Lidhur me të gjeturat e paraqitura në këtë raport, IPK me datë 30.11.2015, ka mbajtur edhe takim përmblyës me menaxhmentin e DMH-së dhe me zyrtarët policor të kësaj drejtorie. Në këtë takim janë diskutuar të gjitha detajet e paraqitura në raport ku si konkluzion i këtij takimi ka dalë se të gjithë të pranishmit janë pajtuar se të gjeturat e inspektimit të paraqitura në raport janë reale.

2. HYRJE

2.1 Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, neni 24 pika 1, 2, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka bërë Inspektim të jashtëzakonshëm nga data 15.09.2015 deri me 05/10.2015, në Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Departamentit të Policisë Kufitare të PK-së, me temën “Vlerësimin e Menaxhimit të Punës së DMH-së”

2.2 Qëllimi i organizimit dhe funksionalizimit të këtij inspektimi të jashtëzakonshëm ka qenë të evidentojë, analizojë dhe vlerësojë performancën e strukturave policore të PK-së gjatë periudhës kohore të mbulimit të inspektimit, evidentimi i rasteve tjera të mundshme nëse kërkojnë trajtim sipas autorizimeve ligjore të IPK-së si dhe dhënien e rekomandimeve për mënyrat e përmirësimit të kryerjes së detyrave policore.

2.3 Objekt i inspektimit të jashtëzakonshëm është Vlerësimi i Menaxhimit të Punës në DMH gjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore në pajtim me ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.

2.4 Subjekt i këtij inspektimi ka qenë Drejtoria për Migrim dhe të Huaj, Njësit për Migrim në kuadër të Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare, Stacioni Policor në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

2.5 Me rastin e planifikimit të aktiviteteve në funksionalizimin e inspektimit të jashtëzakonshëm, Departamenti i Inspektimeve të IPK-së ka vënë këto objektiva të inspektimit:

- Vlerësimi dhe identifikimi i rregullativës ligjore të DMH-së;
- Vlerësimi i mirëmbajtjes dhe rifreskimit të bazës së të dhënave të DMH-së dhe dosjeve të rasteve;
- Vlerësimi i efikasitetit të punës inspektuese të DMH-së si dhe komunikimit dhe adresimit të të gjeturave të inspektimit;

2.6 Periudha e mbulimit për këtë inspektim ka qenë, periudha kohore prej 01.01.2015 deri me 30.06.2015.

2.7 E autorizuar të kryejë inspektim të jashtëzakonshëm, IPK-ja ka angazhuar inspektorët, të cilët në vazhden e nxjerrjes së informacionit të duhur, kanë siguruar:

- të dhëna nga materialet të siguruara gjatë inspektimit nga njësitë policore që kanë qenë subjekt të inspektimit, dokumente të shkruara, si raporte të ndryshme periodike, dosje fizike, të dhëna nga bazat e të dhënave të DMH-së, dhe
- intervista nga punonjës policorë të nivelit të lartë drejtues, si dhe të nivelit zbatues, si në vijim:
 - Drejtori i Drejtorisë Për Migrim dhe të Huaj;
 - Shefi i sektorit Për Kontrollin e të Huajve;
 - Shefi i sektorit për Deportime;
 - Zyrtar policor nga Sektori për të Huaj;
 - Zyrtar policor nga Sektori për Deportime;
 - Drejtorët Rajonal të Policisë Kufitare;
 - Komandantin e Stacionit Policor në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës;
 - Udhëheqësit e Njërive për Migrim në kuadër të Drejtorive Rajonale.

2.8 Inspektimi i jashtëzakonshëm i zhvilluar nga inspektorët e Departamentit të Inspektimit është përqendruar në këto fusha kryesore:

- Vlerësimi i rregullativës ligjore si dhe respektimi i saj nga ana e zyrtarëve policor të DMH-së,
- Baza e të dhënave për personat e huaj, evidentimi, mirëmbajtja dhe rifreskimi i saj,
- Llojet e Bazave të të dhënave (Sistemeve) të cilat shërbejnë për regjistrimin dhe mbajtjen nën kontroll të personave të huaj që qëndrojnë në Kosovë,
- Bashkëpunimi i DMH-së me njësit tjera relevante në kuadër të PK-së,
- Bashkëpunimi i DMH-së me Institucionet tjera të cilat në mënyrë direkte apo indirekte merren me trajtimin e personave të huaj,
- Performanca e zyrtarëve policor të DMH-së, duke vlerësuar efikasitetin e punës Inspektuese të DMH-së.

2.9 Inspektimi i jashtëzakonshëm i autorizuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së është bazuar në këtë kuadër ligjor:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji i Policisë së Kosovës (2011 /04-L-076);
- Ligji për të Huaj (04/L219);
- Udhëzimi administrativ Nr. 23/2010-MPB Për Mirëmbajtjen dhe menaxhimin e regjistrave Për të Huajt;
- Procedurat Standarde të Operimit për Zbatimin e dispozitave ndëshkimore nga Ligji për të huajt;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Migracion dhe plani i veprimit 2012-2017;
- Doracaku i Parimeve dhe Procedurave;

3. ORGANIZIMI DHE STRUKTURA NË DREJTORINË PËR MIGRIM DHE TË HUAJ

3.1 Drejtoria për Migrim dhe të Huaj është Drejtori në kuadër të Divizionit për Menaxhim të Integruar të Kufirit (Departamenti për Kufi). Kjo drejtori në kuadër të vetin ka Sektorin për Kontrollin e të Huajve dhe Sektorin për Deportime.

3.2 Lista e personelit të autorizuar për Departamentin për Kufi në PK, e aprovuar më 07/05/2015 nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë parasheh personelin me sa vijon: Drejtoria për Migrim dhe të Huaj ka 16 zyrtar; personeli i kësaj drejtorie në bazë të listës së autorizuar është ndarë në Sektorin për Kontrollin e të Huajve që ka 10 zyrtar nga te cilët një (1) kapiten, një (1) toger dhe tetë (8) zyrtar policor), kurse Sektori për Deportime ka gjashtë (6) zyrtar nga te cilët një (1) toger, një (1) rreshter dhe katër (4) zyrtar policor.

3.3 Gjatë inspektimit IPK-ja gjeti se Drejtoria e Migrimit dhe të Huajve sa i përket shpërndarjes së personelit sipas listës së autorizuar dhe gjendjes momentale nuk është në përputhje. Në kohën e inspektimit në Sektorin për Kontrollin e të Huajve nuk ishin të mbuluara pozita e kapitenit dhe togerit. Mos mbulimi i dy pozitave udhëheqëse në Sektorin për Kontrollin e të Huajve ndikon drejtpërsëdrejti në mbarëvajtjen e punës së këtij sektori si dhe në mbarëvajtjen e punës së DMH-së.

3.4 Sektori për kontrollin e të huajve kryen inspektime në të gjitha institucionet dhe organizatat të cilat kanë të punësuar persona të huaj, duke përfshirë; OJQ-të, Bizneset, Institucionet Shkollore, klubet sportive, si dhe në të gjitha vendet ku dyshohet se ka shtetas të huaj (duke përfshirë edhe shtëpitë private) të cilët qëndrojnë në mënyrë të kundërligjshme në Republikën e Kosovës. Kurse Sektori për Deportime merret me deportimin e të huajve të cilët kanë kryer shkelje ligjore. Të gjeturat nga inspektimi tregojnë se ndarja e detyrave në mes të këtyre dy sektorëve në praktikë nuk aplikohet plotësisht, pasi që të gjitha detyrat kryhen bashkërisht nga zyrtarët e të dy sektorëve. Pra, gjatë inspektimeve të cilat zhvillohen nga sektori i kontrollit angazhohen edhe zyrtarët e Sektorit për Deportime si dhe anasjelltas.

3.5 Kontrolli i të huajve, përveç që është i organizuar nga niveli qendror DMH, është i organizuar edhe nga niveli i Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare përmes Njësive për Migrim, si dhe Stacionit Policor në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Këto njësi sipas strukturës organizative janë të strukturuar në Drejtoritë Rajonale të Policisë Kufitare dhe ju përgjigjen këtyre drejtorive përmes zinxhirit komandues përkatës, mirëpo lidhur me aktivitetet në kontrollin e të huajve i raportojnë edhe DMH-së në baza të rregullta javore dhe mujore.

3.6 Drejtoritë Rajonale Kufitare dhe Stacioni Policor i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës në bazë të listës së autorizuar për personel kanë këtë strukturë: Drejtoria Rajonale Kufitare Perëndimi, Njësia për Migrim dhe të huaj ka katër (4) zyrtar nga te cilët një (1) rreshter dhe tre (3) polic; Drejtoria Rajonale Kufitare Veriu, Njësia për Migrim dhe të huaj ka tre (3) zyrtar nga te cilët një (1) rreshter dhe dy (2) polic; Drejtoria Rajonale Kufitare Lindje, Njësia për Migrim dhe të huaj ka tre (3) zyrtar nga te cilët një (1) rreshter dhe dy (2) polic dhe Stacioni i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës ka gjashtë (6) zyrtar nga te cilët një (1) toger dhe pesë (5) polic.

4. VLERËSIMI DHE IDENTIFIKIMI I RREGULLATIVËS LIGJORE NË DREJTORINË PËR MIGRIM DHE TË HUAJ

4.1 Të drejtat dhe detyrimet e të huajve në Republikën e Kosovës, hyrja, qëndrimi, qarkullimi dhe punësimi i shtetasve të huaj brenda territorit të Republikës së Kosovës rregullohet me dispozitat ligjore që burojnë nga Ligji për të Huajt Nr. 04/L219 dhe akteve tjera nënligjore që burojnë nga ky ligj. Si akte relevante nënligjore për fushën e lartcekur janë nxjerrë Udhëzimi Administrativ Nr. 23/2010-MPB Për Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e Regjistrave për të Huajt, Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2013 Për Zbatimin e Dispozitave Ndëshkimore nga Ligji Për të Huajt, Procedua Standarde të Operimit e Njesisë për Kontrollim e të Huajve NDPK-05/001/2012 dhe Procedura Standarde e Operimit për Zbatimin e Dispozitave Ndëshkimore nga Ligji për të Huajt .

4.2 Udhëzimi Administrativ Nr. 23/2010 Për Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e Regjistrave për të Huajt merret me rregullimin e mënyrës së mirëmbajtës dhe menaxhimin e të dhënave personale të të huajve në Republikën e Kosovës. Në bazë të këtyre dispozitave që burojnë nga ky udhëzim regjistri qendror menaxhohet dhe mirëmbahet nga ana Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

4.3 Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2013 Për zbatimin e Dispozitave Ndëshkimore nga Ligji Për të Huajt, përcakton mënyrën e shqiptimit të gjobave nga ana e Policisë së Kosovës në zbatimin e autorizimeve dhe kompetencave policore të parashtruara në Ligjin për të Huaj. Po ashtu ky udhëzim rregullon mënyrën e administrimit të gjobave si dhe procedurave që ndiqen për shqiptimin e gjobës dhe masat tjera administrative plotësuese për shkeljet e përcaktuara në Ligjin për të Huajt.

4.4 Më qellim të funksionalizimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore që burojnë nga ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fushën e migrimit dhe të huajve në territorin e Kosovës, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj e Policisë së Kosovës ka hartuar dokumentet e Procedurave Standarde të Operimit siç janë të precizuar në paragrafin 4.1 më të cilat detajon veprimet dhe autorizimet konkrete të njësive policore të autorizuara gjatë kryerjes së detyrave policore gjatë ushtrimit të kontrollit dhe trajtimit të personave të huaj në territorin e Kosovës.

4.5 Çdo shtetas i huaj obligohet që gjatë lëvizjes dhe qëndrimit të tij në Republikën e Kosovës ti përmbahet legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës. Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Departamentit të Policisë Kufitare është e obliguar të bashkëpunoj ngushtë me agjenci dhe institucione tjera relevante të zbatimit të ligjit që merren me trajtimin e migrimit dhe të huajve në Territorin e Republikës së Kosovës.

4.6 Fushëveprimi i detyrave dhe autorizimeve të kësaj drejtorie është kontrolli i hyrjes, lëvizjes dhe qëndrimi i shtetasve të huaj në territorin e Kosovës. Në kuadër të strukturës organizative të Policisë së Kosovës, kjo Drejtori është e ndarë në dy sektorë dhe atë në: Sektorin për Kontrollin e të Huajve dhe Sektori për Deportimeve. Në kuadër të këtij fushëveprimi Drejtoria për Migrim dhe të huaj ka këto detyra:

- a) Inspektimin e Bizneseve (hoteliere, ndërtimore, tregtare, prodhuese etj.) institucioneve shëndetësore, arsimore, kulturore, sportive etj. Apo lokacioneve të ndryshme në brendi të territorit të Kosovës ku dyshohet se ka imigrant të parregullt;
- b) Zbatimin e procedurave për masat ndëshkimore, mbajtjen, largimin dhe dëbimin e të huajve;

- c) Verifikimin e shtetasve të huaj që aplikojnë për viza të RKS në përfaqësi diplomatike dhe konsullore.
- d) Trajtimi fillestar i azilkërkuesve sipas Ligjit për Azil;
- e) Ngritja e performancës së DMH-së në parandalimin dhe luftimin e imigrimit të parregullt.

4.7 Për përmbushjen e objektivave strategjike të Departamentit të Policisë Kufitare, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj ka hartuar Planin Punues për vitin 2015 që përfshin objektiva dhe aktivitete konkrete për zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në fushën e trajtimit kontrollit të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Në këtë planë përfshihen e aktiviteti bashkëpunues me të gjithë akteret relevant që me ligj janë të obliguar të përfshihen në trajtimin e hyrjes, qëndrimit dhe aktivitetit punues të të huajve në Kosovë.

5. VLERËSIMI I MIRËMBAJTJES DHE RIFRESKIMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE TË DMH-SË DHE DOSJEVE TË RASTEVE

5.1 Autoritetet kompetente shtetërore për trajtimin e të huajve mbledhin dhe administrojnë të dhënat personale për të huajt nga organet shtetërore, subjektet private apo të huajt me qëndrim në Republikën e Kosovës, si dhe nga vetë i huaji, i regjistrojnë këto të dhëna në bazat e të dhënave për të huajt, si dhe në evidencat e posaçme kur kjo:

- Është e parashikuar me ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Kosovës;
- Është në interes të të huajit dhe i njëjti nuk e kundërshton atë;
- Kërkohet me qëllim të mbrojtjes së rendit publik, sigurisë shtetërore dhe shëndetit publik¹.

5.2 Regjistri qendror për të huajt, në tekstin e mëtejme i referuar si regjistër, krijohet menaxhohet dhe mirëmbahet në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme².

5.3 Ligji për të Huajt dhe Udhëzimi Administrativë Për Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e Regjistrave për të Huajt, e obligon DSHAM-in që të mbaj regjistrin qendror për të huajt dhe njëkohësisht sipas këtij udhëzimi administrativ në këtë regjistër i lejohet qasje DMH-së. DMH me qëllim të mbledhjes së informatave për të huajt lidhur me: lejen e qëndrimit, vendbanimin, të dhënat personale të të huajit, shteti prej nga vjen, profesionin etj. shërbehet me të dhënat nga regjistri qendror, pra, nga regjistri i DSHAM-së. Kurse sa i përket informatave se personi i huaj ka pas apo jo ndonjë ndalesë hyrje, a ka qenë i gjobitur në Republikën e Kosovës, a ndodhet në stop listë, e kaluara kriminale etj. këto të dhëna i shfrytëzon nga sistemi BMS dhe nga sistemi SIPK.

5.4 Sistemi BMS (Border Menaging System), është sistem i regjistrimit elektronik në të cilin regjistrohen të gjitha hyrjet dhe daljet në Pikë Kalimet Kufitare. Në kuadër të këtij sistemi është e integruar stop lista e personave të ndaluar për qarkullim dhe të kërkuar nga policia, ku me të skanuar dokumentin e udhëtimit nëse ndonjë person ndodhet në stop listë atëherë sistemi reagon dhe lajmëron detajet e regjistrimit në stop listë.

5.5 DMH me qëllim të evidentimit të aktiviteteve nga fushë veprimtaria e sajë, ka krijuar bazat e të dhënave për secilin aktivitet veç e veç. Mirëpo duhet theksuar se të gjitha këto baza të të dhënave në një formë janë të adaptuara, pasi që të gjitha janë të punuara në programin aplikativ Exel, program ky i cili e mundëson qasjen për ndryshimin e të dhënave në çdo kohë. Për futjen e të dhënave në këto baza të të dhënave janë të autorizuar zyrtarët policor të caktuar dhe se nuk kanë qasje zyrtarët tjerë të cilët nuk janë të autorizuar pasi që secili kompjuter është i siguar dhe nuk hapet pa fjalëkalim (pasëord). Duhet theksuar se përveç evidencave elektronike në DMH mbahen edhe evidencat fizike, pra librat e evidencave për secilin aktivitet.

➤ Bazat e të dhënave të adaptuara janë:

- bazën e të dhënave për Inspektimet,
- bazën e të dhënave për gjobat,
- bazën e të dhënave për verifikimin për viza,

¹ Ligji Nr.04/L-219 për të Huajt, neni 120, parag.1

² Udhëzim Administrativ Nr.23/2010-MPB Për Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e Regjistrave për të Huajt

- bazën e të dhënave për azil kërkues,
- bazën e të dhënave për akomodimin,
- bazën e të dhënave për leje pune dhe
- bazën e të dhënave për urdhër largimet.

5.6 Inspektorët gjatë inspektimit kanë kontrolluar këto baza të të dhënave në lidhje me përmbajtjen e të dhënave të evidentuara, azhurnimin e të dhënave si dhe plotësimin e të gjitha të dhënave. Gjithashtu, është bërë edhe krahasimi i të dhënave të evidentuara në bazën e të dhënave me të dhënat e evidentuara në librat e evidencave. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se të dhënat e evidentuara në bazën e të dhënave janë në përputhje të plotë me të dhënat e evidentuara në librat e evidencave.

5.7 Sa i përket azhurnimit të të dhënave dhe mirëmbajtjes së bazave të të dhënave, Inspektorët kanë vërejtur se këto baza të të dhënave azhurnohen dhe mirëmbahen rregullisht duke futë të dhënat nga secili aktivitet si dhe duke i plotësuar të gjitha rubrikat e parapara. Kurse sa i përket përmbajtjes së të dhënave vlen të theksohet se këto baza të të dhënave janë mjaft gjithëpërfshirëse pasi që varësisht nga qëllimi i krijimit të sajë janë përcaktuar edhe se cilat të dhëna duhet t'i përmbajë, si p.sh.

- Baza e të dhënave për inspektime në vete përmban të dhënat si: numri i referencës, data e inspektimit, emri i biznesit, emri i pronarit, adresa, qyteti, dokumenti i konfiskuar, fletëthirrja, emri dhe mbiemri i te dyshuarit, gjinia, shtetësia, masat e ndërmarra, zyrtarët policor dhe qëllimi i inspektimit.
- Baza e të dhënave për gjobat e shqiptuara në vete përmban të dhënat si: numri rendor, numri i rastit, numri i inspektimit, numri serik i procesverbalit, biznesi dhe vendi, profesioni, data e incidentit, emri dhe mbiemri i kundërvajtësit, data e lindjes, mosha, nacionaliteti, gjinia, kundërvajtja, neni, data e marrjes së vendimit, data e ekzekutimit të urdhër-largesës, numri serik i faturës, shuma e gjobës, zyrtari policor që e plotëson proces verbalin dhe e paguar Po/Jo.
- Baza e të dhënave për verifikimin për viza në vete përmban të dhënat: numri rendor, data e verifikimit, ambasada, biznesi, emri i garantuesit, numri i të ftuarve, emri dhe mbiemri i të ftuarit, data e lindjes, shtetësia, numri i dokumentit, gjinia, përgjigja, kategoria e vizës, data e hyrjes dhe e daljes.
- Baza e të dhënave për azil kërkues në vete përmban të dhënat: numri rendor, data e kërkesës, emri dhe mbiemri, datëlindja, mosha, shtetësia, vendi i kërimit të azilit, trajtimi i tyre është bërë, vendkalimi - pikën kufitare, gjinia dhe dokumenti i identifikimit.
- Baza e të dhënave për akomodimin në vete përmban: numri rendor, emri i hotelit, data e lajmërimit, data e ç'lajmërimit, nacionaliteti, emri dhe mbiemri dhe numri i dokumentit.
- Baza e të dhënave për urdhër largimet në vete përmban: numri rendor, data, emri dhe mbiemri, data e lindjes, shtetësia, arsyeja, data e daljes, gjinia, ndalesa, profesioni, njësia, numri i procesverbalit.
- Baza e të dhënave për leje pune në vete përmban: numri i referencës, data e lajmërimit, emri dhe mbiemri, data e lindjes, numri i pasaportës, shtetësia, emri i biznesit, adresa e biznesit, data e hyrjes, profesioni, PKK, data e MPMS, vendimi i MPMS, kohëzgjatja e punës, data e ç'lajmërimit, periudha e dytë.

5.8 Krahas inspektimit të bazave të të dhënave, Inspektorët kanë kontrolluar edhe dosjet fizike të shqiptimit të gjobave në aspektin e kompletimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Dosja për vendimet e shqiptimit të gjobave, përmban kopjen e vendimit, faturën e dizajnuar për pagesën e gjobës, dëshminë e pagesës së gjobës, kopjen e dokumentit të identifikimit dhe raportin e inspektimit³.

5.9 Dosjet për vendimet e shqiptimit të gjobave, vendimet e të cilave i ka lëshuar DMH-ja pas kompletimit fajlohen dhe ruhen në DMH. Kurse, dosjet për vendimet e shqiptimit të gjobave të cilat janë lëshuar nga Drejtoritë Rajonale të Policisë Kufitare dhe Stacionit Policor në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP), pas fajllimit ruhen në Drejtorinë Rajonale gjegjësisht në Stacionin Policor në ANP ku janë nxjerrë vendimet.

5.10 Inspektorët kanë analizuar dosjet për vendimet e gjobave, në aspektin e kompletimit të dosjes duke krahasuar përmbajtjen e dosjeve me obligimet që dalin nga Procedura Standarde e Operimit për zbatimin e dispozitave ndëshkimore nga ligji për të huajt. Për analizim janë kontrolluar të gjitha dosjet për vendime të gjobave të cilat janë shqiptuar gjatë kësaj periudhe kohore (01.01.2015-30.06.2015) nga DMH, pra janë kontrolluar dhe analizuar 317 dosje. Analizimi i këtyre dosjeve ka vu në pah se dosjet jo gjithmonë kompletohen duke i respektuar plotësisht Procedurat Standarde të Operimit, pasi që në disa raste në dosje nuk janë të vendosura dokumentet si: kopja e dokumentit të identifikimit, raporti i inspektimit, vërtetimi për sekuestrim, procesverbali dhe fatura e pagesës së gjobës. Pra në 1 nga 317 dosjet mungonte fatura e pagesës së gjobës, në 1 nga 317 dosjet mungonte kopja e dokumentit të identifikimit, në 3 nga 317 dosjet mungonte raporti i inspektimit, në 34 nga 317 dosjet mungonte vërtetimi për sekuestrim dhe në 1 nga 317 dosjet mungonte procesverbali.

5.11 Gjatë fazës së analizimit të dosjeve për vendimet e gjobave të cilat janë shqiptuar nga Drejtoritë Rajonale të Policisë Kufitare, janë kontrolluar të gjitha dosjet pra 98 dosje, ku të gjeturat tregojnë se përgjithësisht dosjet ishin të kompletuara konform Procedurës Standarde të Operimit për zbatimin e dispozitave ndëshkimore nga Ligji për të Huajt, me përjashtim të një rasti ku në dosje mungonin dëftesa e pagesës dhe kopja e dokumentit të identifikimit.

³ Procedura standard e operimit për zbatimin e dispozitave ndëshkimore nga ligji për të huajt. DPK-05/005/2014.

6. VLERËSIMI I EFIKASITETIT TË PUNËS INSPEKTUESE TË DMH-SË SI DHE KOMUNIKIMIT DHE ADRESIMIT TË TË GJETURAVE TË INSPEKTIMIT

6.1 Në kuadër të Departamentit të Policisë Kufitare, më konkretisht në kuadër të Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj, gjendet edhe Sektori i Kontrollit. Ky Sektor përmes aktiviteteve inspektuese, kryen kontrollin lidhur me rregullshmërinë e qëndrimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Sa i përket kompetencave territoriale të veprimit ky sektor ka kompetencë të veprimit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu ky sektor ka kompetencë të kontrolloj apo inspektoj çdo vend ku dyshohet se qëndrojnë në mënyrë të paligjshme persona të huaj, duke përfshirë këtu institucionet shkollore, OJQ-të, bizneset apo edhe mjediset private.

6.2 Punës së Sektorit të Kontrollit në çdo vit kalendarik i paraprinë plani vjetor i inspektimeve. Përveç planit vjetor të inspektimeve ky sektor harton edhe planet operative sa herë që të organizojnë inspektime të përbashkëta me Inspektoratin e Punës, Inspektorat ky i cili është në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

6.3 Meqenëse periudha e mbulimit të inspektimit ka qenë prej 01.01.2015 deri me 30.06.2015, Inspektorët gjatë kontrollimit të raporteve të Inspektimit si dhe data bazës ku janë të evidentuara inspektimet e këtij sektori, kanë gjetur se gjatë kësaj periudhe kohore janë kryer 821 inspektime në lokacione të ndryshme. Gjithashtu Inspektorët kanë vërejtur se gjatë këtyre inspektimeve janë kontrolluar biznese të fushë veprimtarive të ndryshme si: biznese të cilat ofrojnë shërbime hoteliere, Kompani Farmaceutike, Kompani Ndërtimi, Furra Buke etj. Duhet theksuar se në kuadër të këtyre inspektimeve bëjnë pjesë edhe inspektimet që kanë të bëjnë me verifikimin e kushteve për dhënien e vizave.

6.4 Zyrtarët policor pjesëmarrës në inspektime, pas çdo inspektimi hartojnë raporte të inspektimit, në të cilat pasqyrohen të gjeturat gjatë këtyre inspektimeve. IPK gjatë Inspektimit kanë kontrolluar të gjitha raportet e inspektimeve të kryera nga zyrtarët policor, pra gjithsejtë 821 raporte të inspektimit. Nga kontrollimi i këtyre raporteve ka rezultuar se gjatë këtyre inspektimeve zyrtarët policor kanë has në 531 persona të cilët kanë qenë duke qëndruar apo edhe duke punuar në mënyrë të kundërligjshme, me ç'rast të njëjtëve ju kanë konfiskuar dokumentet personale, u janë plotësuar procesverbalet si dhe u janë dhënë fletë thirrjet që të paraqiten në kohën e caktuar në DMH.

6.5 Gjatë analizimit të përmbajtjes së raporteve të inspektimit lidhur me paraqitjen e të gjeturave në terren, Inspektorët kanë vërejtur se këto raporte në disa raste janë të mangëta sa i përket paraqitjes së të gjeturave. Pra, mungojnë të dhënat lidhur me adresën e vendbanimit të personave të dyshuar, të dhënat e personave të dyshuar siç ishte rasti i paraqitur në raportin me numër reference 723/2015, të dhënat lidhur me natyrën e punës të cilën kanë qenë duke kryer të dyshuarit, të dhënat se a është plotësuar procesverbali, të dhënat lidhur me konfiskimin e dokumenteve personale etj.

6.6 Gjithashtu nga analizimi i raporteve të inspektimit është vërejtur se zyrtarët policor në rastet kur kanë hasë në persona të huaj të cilët qëndrojnë apo punojnë në mënyrë të kundërligjshme, të njëjtëve ju kanë konfiskuar dokumentet personale dhe ju kanë dhënë dëshminë për sekuestrimin e dokumentacionit. Mirëpo edhe në rastet kur zyrtarët policorë kanë sekuestruar dokumentacionin, ata gjatë prezantimit të të dhënave personale të personave të dyshuar në raportin e inspektimit kanë paraqitur gabimisht emrin apo mbiemrin e tyre siç ishte rasti në raportin e inspektimit me numër 782/2015 dhe në raportin me numër 807/2015.

6.7 Neni 108, paragrafi 3 i Ligjit Nr.04/L-219 Për të Huajt thotë: Policia Kufitare mundë të ndaloj të huajin në Qendër të Mbajtjes, për arsye të sigurisë publike, vërtetim të identiteti apo për arsye tjera. Kurse neni 116 paragrafi 1.4 thotë: Policia Kufitare, në ushtrim të detyrave të parashikuara me ligj shoqëron të huajin, i cili nuk disponon dokument identifikimi, leje qëndrimi, dokument udhëtimi ose ndonjë dokument tjetër që dëshmon identitetin e tij.

6.8 Inspektorët gjatë analizimit të raporteve të inspektimit kanë vërejtur se zyrtarët policor edhe në rastet kur kanë hasë në persona të huaj duke punuar dhe të cilët nuk posedonin dokument të identifikimit dhe as leje të qëndrimit ju kanë lëshuar vetëm fletë thirrjen që të njëjtit të paraqitën në DMH. Pra, zyrtarët policorë edhe pse nuk kanë mundë që të verifikojnë identitetin e personave të huaj nuk i kanë zbatuar dispozitat e ligjit për të huaj të paraqitura më lartë, por vetëm u kanë dhënë fletë thirrjet që të paraqitën në DMH. Vlen të theksohet se sipas Menaxhmentit të DMH-së, deri te mos zbatimi i këtyre dispozitave ligjore ka ardhë për shkak se në këtë periudhë kohore nuk ka qen funksionale Qendra e Mbajtjes për të Huaj.

6.9 Krahas kontrollimit të raporteve të inspektimit, Inspektorë kanë bërë edhe krahasimin e të dhënave të paraqitura në raportet e inspektimeve me të dhënat e paraqitura në bazën e të dhënave për inspektime. Duhet theksuar se të gjeturat nga ky krahasim tregojnë se të dhënat e paraqitura në bazën e të dhënave për inspektime përputhën plotësisht me të dhënat e paraqitura në raportet e inspektimeve. Pra, duke i përfshirë të dhënat si: numri i referencës, data e inspektimit, emri i biznesit, emri i pronarit, emri i të dyshuarit, adresa, dokumenti i konfiskuar, lëshimi i fletë thirrjes, shtetësia, masat e ndërmarrura, policët pjesëmarrës në inspektim si dhe arsyeja e inspektimit.

6.10 Qëndrim të përkohshëm i jepet të huajit i cili dëshiron të qëndroj në Republikën e Kosovës me qëllim të: ribashkimit familjar, arsimit parauniversitar apo arsim të lartë, kërkime shkencore, arsye humanitare duke përfshirë refugjatet, personat nën mbrojtje plotësuese dhe viktimat e trafikimit me njerëz ose viktimat të kontrabandës me migrantë dhe të huaj si dhe të huajt të cilët kanë shprehur vullnet të bashkëpunimit me autoritetet kompetente , punë dhe punësimin të punëtorit të sistemuar.

6.11 Gjatë periudhës kohore prej 01.01.2015 e deri me 30.06.2015, në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM) janë paraqitë 1888 kërkesa leje qëndrim të përkohshëm, nga të cilat janë lëshuar 1430 vendime pozitive, 130 kërkesa janë në pritje si dhe 328 vendime pozitive janë lëshuar pa caktim të kohëzgjatjes së afatit të leje qëndrimit.⁴

6.12 Të huajit, i cili është gjetur duke qëndruar dhe punuar në mënyrë të paligjshme në Republikën e Kosovës , organi kompetent Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM) i nxjerrë urdhrin e largimit në formë të vendimit i cili përmban të dhënat personale të të huajit, shkakun e urdhrë largimit, afatin brenda të cilit duhet të largohet, piken e kalimit kufitar, afatin e ndalesës së hyrjes në territorin e Republikës së Kosovës dhe obligimin e të huajit që të lajmërohet te organi i autorizuar për kontrollin e kufirit shtetëror gjatë largimit nga territori i Republikës së Kosovës.

⁴ Raporti statistikor K1 dhe K2 2015 DSHAM/MPB

6.13 Gjatë periudhës kohore prej 01.01.2015 e deri me 30.06.2015, nga Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM) janë lëshuar 39 vendime për urdhër largime. Vlen të theksohet se kërkesën për nxjerrjen e vendimit për urdhër largime e bënë Policia e Kosovës më konkretisht DMH.

6.14 Largimi me forcë i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës behet nga Policia Kufitare atëherë kur i huaji nuk është larguar nga Republika e Kosovës brenda afateve kohore të përcaktuara në urdhër largim pa ndonjë arsye; nuk e ka lëshuar territorin e Republikës së Kosovës deri në gjashtëdhjetë (60) ditë pas përfundimit të vizës apo të leje qëndrimi; është dënuar për vepër penale për të cilën legjislacioni i Kosovës parasheh dënimin prej një (1) viti me heqje lirie; është ripranuar nga një vend në kuadër të marrëveshjeve të ripranimit në fuqi në Republikën e Kosovës.

6.15 Nga kontrollimi i evidencave në bazën e të dhënave për urdhër largimet, Inspektorët kanë gjetur se, gjatë periudhës kohore prej 01.01.2015 e deri me 30.06.2015, nga Policia Kufitare, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj janë ekzekutuar 12 urdhër largime me forcë.

6.16 Masat ndëshkimore në gjobë të parapara nga neni 128 deri me nenin 134 të ligjit nr. 04/L-219 për të huajt, shqiptohen nga Policia Kufitare dhe Inspektorati i Punës, për të huajt të cilët nuk e respektojnë legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

6.17 Sa i përket shqiptimit të gjobave gjatë periudhës kohore prej 01.01.2015 e deri me 30.06.2015, nga Policia Kufitare, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj janë shqiptuar 314 gjoba për të huajt të cilët kanë renë ndesh me ligjin për të huaj. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kohore janë shqiptuar tri (3) gjoba për shtetas të Republikës së Kosovës të cilët nuk e kishin lajmëruar akomodimin e shtetasve të huaj, ashtu siç parashihet me ligjin për të huajt.

6.18 Inspektorët gjatë kontrollimit dhe analizimit të 821 raporteve të inspektimit vërehet se janë has në 531 persona të cilët kanë qenë duke qëndruar apo edhe duke punuar në mënyrë të kundërligjshme. Kurse gjatë kontrollimit të bazave të të dhënave si: Baza e të dhënave për gjobat, baza e të dhënave të inspektimeve, baza e të dhënave për urdhër-largimet si dhe bazën e të dhënave për anulimin e leje-qëndrimit afatshkurtër, mundë të shohim të dhënat lidhur me shqiptimin e gjobave të shqiptuara gjatë kësaj periudhe kohore. Pra, nga analizimi i bazave të të dhënave del se nga 531 personat e hasur në kundërvajtje, ndaj 218 prej tyre janë shqiptuar gjoba me vlerë monetare, 16 anulime të leje-qëndrimit afat shkurtër, 39 vendime për urdhër largime vullnetare dhe 12 urdhër largime me forcë, 18 raste të dokumenteve të mbetura si dhe për 228 persona Inspektorët nuk kanë gjetur të dhëna të ndërmarrjes së masave ndëshkuese.

6.19 Gjithashtu në bazën e të dhënave për gjobat Inspektorët kanë has se nga DMH janë shqiptuar 99 gjoba për kundërvajtësit të cilët vet janë paraqitur pran zyrave të DMH-së.

6.20 Përveç Sektorit për Kontrollin e të Huajve (DMH), inspektime kryejnë edhe Njësitë për Migrim të cilat janë në kuadër të Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare dhe Stacionit Policor në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Inspektorët e IPK-së kanë inspektuar edhe këto njësi, duke mbledhur të dhëna lidhur me mënyrën e organizimit të inspektimeve nga këto njësi, evidentimin e të dhënave në bazat e të dhënave, shqiptimin e masave ndëshkuese (gjobave) për personat e huaj si dhe menaxhimin e dosjeve të shqiptimit të gjobave. Duhet theksuar se sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013 Për Zbatimin e Dispozitave Ndëshkimore nga Ligji për të Huajt, kompetentë për shqiptimin e gjobave në kuadër të Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare është Drejtori i Drejtorisë, kurse në kuadër

të Stacionit Policor në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës kompetent për shqiptimin e gjobave është Komandanti i Stacionit Policor të ANP-së.

6.21 Gjatë periudhës 01.01.2015 deri më 30.06.2015, nga Njësitë për Migrim të Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare janë kryer 183 inspektime, me ç'rast janë shqiptuar 98 gjoba për personat e huaj të cilët kanë kryer shkeljet të cilat janë të sanksionuara me ligjin për të huajt. Në vazhdim do të paraqesim në mënyrë tabelore të dhënat statistikore të aktiviteteve të DMH-së, Njësive për Migrim të Drejtorive Rajonale si dhe të Njesisë për Migrim të Stacionit Policor në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Tabela Nr.1 Aktivitetet e Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj, njësive rajonale dhe Stacionit Policor në ANP për periudhën Janar-Qershor 2015 ⁵	
Gjoha të shqiptuara	415
Inspektime	1004
Depërtime të ekzekutuara	17
Kërkesa për Urdhër Largim	39
Urdhër largimet e ekzekutuara me forcë	12
Verifikim i kërkesave për viza në Republikës e Kosovës nga DMH	567
Kërkesa të aprovuara për viza nga DMH	432
Kërkesa të refuzuara për viza nga DMH	135
Azilkërkues	42

6.22 Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt, në mënyrë decisive i ka ndara kompetencat sa i përket shqiptimit të gjobave për personat e huaj. Kështu që në kompetencë të policisë për shqiptimin e gjobave janë rastet kur persona të huaj qëndrojnë në Kosovë pa leje qëndrim, punojnë pa leje pune, nuk posedojnë dokumente valide të identifikimit, ndryshojnë qëllimin e qëndrimit në Kosovë dhe nuk i lajmërojnë organet kompetente për këtë, i japin dokumentet personale në shfrytëzim personit tjetër, ju skadon afati i leje qëndrimit dhe për këtë nuk bëjnë kërkesën me kohë për vazhdimin e leje qëndrimit etj. Kurse sa i përket kompetencës për shqiptimin e gjobave ndaj personave fizik dhe juridik të cilët i punësojnë apo e shfrytëzojnë punën e personave të huaj, është në kompetencë të Inspektoratit të Punës që është në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

6.23 Meqenëse DMH nuk ka kompetenca të ndërmarr veprime ndaj punëdhënësve të të huajve, në të kaluarën në disa raste ishin organizuar inspektime të përbashkëta me Inspektoratin e Punës. Inspektorët gjatë ekzaminimit të dokumentacioneve relevante si dhe nga intervistat e zhvilluara me menaxhmentin e DMH-së, kanë kuptuar se në periudhën kohore janar-qershor të vitit 2015 nuk është organizuar asnjë inspektim i përbashkët i DMH-së me Inspektoratin e Punës. Mirëpo, gjatë kësaj periudhe kohore menaxhmenti i DMH-së, rregullisht e ka njoftuar menaxhmentin e Inspektoratit të Punës lidhur me të gjeturat në teren nga inspektimet e kryera nga ana e zyrtarëve policor të DMH-së duke i dorëzuar në baza të rregullta mujore raportet e inspektimeve.

6.24 Inspektorët e IPK-së, gjatë fazës së ekzaminimit të dokumentave kanë analizuar të gjashtë raportet (janar-qershor 2015) e dërguara nga DMH Inspektoratit të Punës, dhe kanë vërejtur se këto raporte janë mjaftë mirë të detajuara duke përfshirë të gjitha detajet e të gjeturave gjatë inspektimeve dhe të veprimeve të ndërmarruna nga DMH pas përfundimit të inspektimeve. Pra, në këto raporte janë të paraqitura të dhënat si: data e inspektimit, emri dhe mbiemri i personit të huaj, shteti prej nga vjen i huaji, emri i biznesit ku është gjetur i

⁵ Të dhënat e siguruara nga raportet periodike të DMH-së dhe Bazave të të Dhënave

huaji duke punuar, shuma e gjobës së shqiptuar nga DMH për personin e huaj si dhe nenet dhe paragrafët e ligjit për të huajt të cilët janë shkel në këto raste.

6.25 Inspektorët kanë kërkuar nga menaxhmenti i DMH-së informata lidhur me atë se sa i kthejnë përgjigje (informata kthyesë) Inspektorati i Punës DMH-së. Inspektorët kanë siguruar kopje nga komunikimi elektronik në mes të Drejtorit të DMH-së dhe Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës⁶, ku janë të paraqitura vështirësitë në të cilat has Inspektorati i Punës për kontrollin e këtyre subjekteve afariste pasi që ato zakonisht punojnë gjatë natës kur Inspektorati i Punës nuk punon dhe se angazhimi i Inspektorëve gjatë kësaj kohe është me rrezikshmëri të lartë. Gjithashtu në këtë komunikim është paraqitur pamundësia e shqiptimit të gjobave për subjektet afariste që kanë të punësuar në mënyrë të kundërligjshme persona të huaj duke u bazuar vetëm në raportet e DMH-së pasi që Ligji e obligon Inspektoratin e Punës që të përpiloj raport (procesverbal) në vendin e ngjarjes dhe të njëjtin t'ia ofroj punëdhënësit që ta shikoj dhe ta nënshkruaj. Vlen të theksohet se sipas këtij komunikimi të dyja palët pajtohen që të caktojnë një orar të përbashkët për inspektimin e këtyre bizneseve të identifikuara nga DMH.

⁶ Komunikimi elektronik përmes adresës zyrtare të datës 04.09.2015.

7. PËRFUNDIMET

7.1. Rolin kryesor në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të çdo institucioni e luan personeli i atij institucioni, andaj plotësimi i strukturës organizative me personelin adekuat është nevojë e domosdoshme. Kështu që edhe në Policinë e Kosovës, gjegjësisht në Drejtorin për Migrim dhe të Huaj plotësimi i strukturës organizative me personel, sidomos me personelin mbikëqyrës është tejet i domosdoshëm. Inspektimi ka vu në pah se mungesa e personelit mbikëqyrës në sektorin e kontrollit të DMH-së, ka lënë zbrazëti të madhe në menaxhimin e këtij sektori si në organizimin e punëve ashtu edhe në kontrollin e cilësisë së raporteve të inspektimeve të kryera nga zyrtarët policor të këtij sektori.

7.2 Bazë për kryerjen e detyrave të çdo institucioni është edhe kompletimi i infrastrukturës ligjore që e rregullon punën e atij institucioni. Sa i përket infrastrukturës ligjore e cila e rregullon punën e DMH-së, të gjeturat e inspektimit tregojnë se kjo infrastrukturë ligjore është mjaftë mirë e kompletuar si në nivelin primar (Ligji për të Huaj, Ligji për Azil), ashtu edhe në nivelin sekondar (Udhëzimet Administrative) dhe në nivelin terciar (Procedurat Standarde të Operimit). Megjithëse infrastruktura ligjore është e plotësuar në të tria nivelet, gjatë inspektimit është konstatuar se në nivelin terciar, pra, Procedurat Standarde të Operimit për Sektorin e Kontrollit dhe për Sektorin e Deportimeve ende janë të pa azhurnueme konform Ligjit për të Huajt.

7.3 Procedura Standarde e Operimit për zbatimin e dispozitave ndëshkimore nga ligji për të huaj, e obligon DMH-në që të mbajë evidencën fizike dhe elektronike për vendimet e shqiptimit të gjobave duke specifikuar se çka duhet të përmbaj edhe përbërja e dosjes për vendimin e shqiptimit të gjobave. Të gjeturat e inspektimit kanë treguar se zyrtarët e DMH-së, kanë adaptuar bazat e të dhënave në programin aplikativ Exel si për regjistrin e vendimeve për shqiptimin e gjobave ashtu edhe për të gjitha aktivitetet e kësaj Drejtorie. Gjithashtu gjatë inspektimit është konstatuar se këto baza të të dhënave azhurnohen dhe mirëmbahen me rregull nga zyrtarët policor. E metë e këtyre bazave të të dhënave është pasi që programi aplikativ Exel, e lë të hapur mundësin e ndërhyrjes për ndryshimin e të dhënave edhe pas futjes së të dhënave në këto baza të të dhënave. Andaj krijimi i një baze të të dhënave e përbashkët për të gjitha aktivitetet dhe e cila nuk do të lejonte ndërhyrjen e pa autorizuar në të dhënat e paraqitura do të shtonte sigurinë e tyre.

7.4 Kontrollimi i dosjeve fizike të vendimeve për shqiptimin e gjobave, ka rezultuar me të gjeturat se jo gjithëher këto dosje kompletohen konform Procedurës Standarde të Operimit për Zbatimin e Dispozitave Ndëshkimore nga Ligji për të Huaj. Ku, në disa dosje fizike nuk ishin të vendosura kopjet e dokumenteve si: dëshmia e sekuestrimit të dokumentit të identifikimit, raporti i inspektimit, procesverbali apo edhe fatura e pagesës së gjobës.

7.5 Kreu X “Masat Ndëshkimore” i Ligjit për të Huaj, në mënyrë taksative paraqet masat ndëshkimore dhe ekzekutimin e tyre ndaj personave të cilët në një mënyrë apo tjetër shkelin rregullat e paraqitura në ligjin për të huaj. Inspektorët gjatë kontrollimit të raporteve të inspektimeve, dosjeve fizike të vendimeve për shqiptimin e gjobave si dhe të bazave të të dhënave që e mbulojnë këtë fushë kanë vërejtur se jo të gjithë personat e gjetur të cilët kanë kryer shkeljen e ligjit për të huaj janë ndëshkuar. Kjo dukuri më së miri vërehet gjatë krahasimit të numrit të personave të gjetur me shkelje të ligjit gjatë inspektimeve dhe numrit të personave ndaj të cilëve janë shqiptuar gjobat ose masat tjera ndëshkuese.

7.6 Pas çdo inspektimi apo kontrolli të kryer nga zyrtarët policor të Sektorit të Kontrollit, ata hartojnë raportin e inspektimit mbi të gjeturat e atij inspektimi. Nga analizimi i përmbajtjes së këtyre raporteve të inspektimit është vërejtur se këto raporte shpesh nuk janë të

përpilura në mënyrën më të mirë të mundshme. Raportet e inspektimeve shpesh janë të mangëta sa i përket informatave mbi të gjeturat e inspektimit, pasi që në to mungojnë informatat mbi vendbanimin e kundërvajtësve, informata se a është plotësuar procesverbali në vendin e ngjarjes apo a i është dhënë kundërvajtësit dëshmia mbi sekuestrimin e dokumentit të identifikimit. Gjithashtu në këto raporte të inspektimeve vërehen edhe gabime në paraqitjen e të dhënave personale të kundërvajtësit.

8. REKOMANDIMET KRYESORE

Në drejtim të përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme të performancës së personelit policor, IPK-ja nxjerrë për PK-në këto rekomandime kryesore:

1. *IPK rekomandon menaxhmentin e Departamentit të Policisë Kufitare që në afat sa më të shkurtër kohor të mundshëm të bëjë plotësimin e pozitive udhëheqëse në Sektorin e Kontrollit, pasi që këto pozita do të ndikonin drejtpërsëdrejti në mbarëvajtjen e punës së Sektorit si dhe do të ndikonin në rritjen e mbikëqyrjes së plotësimin të dosjeve për vendimet e shqiptimit të gjobave dhe cilësisë së raporteve të inspektimeve.*
2. *IPK rekomandon menaxhmentin e DMH-së, që në afat sa më të shkurtër kohor të bëjë azhurnimin e Procedurave Standarde të Operimit të Sektorit të Kontrollit dhe Sektorit të Departimeve, në mënyrë që këto Procedura Standarde të Operimit të jenë në harmoni me ligjin e ri Nr.04/L-219 Për të Huaj.*
3. *IPK rekomandon menaxhmentin e DMH-së, që në bashkëpunim me Drejtorinë për Teknologji Informative t'i shqyrtoj mundësit e krijimit të një baze të të dhënave të përbashkët për të gjitha aktivitetet e DMH-së, si dhe krijimi i kësaj baze të të dhënave të jetë në njërin prej programeve të posaçme për krijimin e bazave të të dhënave, kjo do të rriste sigurinë dhe saktësinë e këtyre të dhënave.*
4. *IPK rekomandon menaxhmentin e DMH-së që përmes hierarkisë mbikëqyrëse/ gradave gjegjëse të shtoj kontrollin tek zyrtarët policor sa i përket plotësimin të dosjeve fizike me kopjet e dokumenteve të parapara sipas Procedurës Standarde të Operimit për Zbatimin e Dispozitave Ndëshkimore nga Ligji për të Huaj.*
5. *IPK rekomandon menaxhmentin e DMH-së që të angazhohet më shumë në zbatimin e Kreut X "Dispozita Ndëshkimore", të Ligjit për të Huaj, në mënyrë që të shmanget mospërputhja e numrit të personave të gjetur në shkelje të Ligjit për të Huaj dhe personave ndaj të cilëve janë ndërmarrë masat ndëshkimore.*
6. *IPK rekomandon menaxhmentin e DMH që përmes hierarkisë mbikëqyrëse/ gradave gjegjëse të shtoj kontrollin e cilësisë së raporteve të inspektimeve, në mënyrë që në të ardhmen këto raporte të jenë më të pajisura më të dhëna nga të gjeturat e inspektimit si dhe të shmangen nga gabimet teknike gjatë përpilimit të raporteve.*

9. PLANI I VEPRIMIT TË PK-së PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE TË IPK-së

Nr	Rekomandimi	Komentet	Plani i veprimit
1.	IPK rekomandon menaxhmentin e Departamentit të Policisë Kufitare që në afat sa më të shkurtër kohor të mundshëm të bëjë plotësimin e pozitave udhëheqëse në Sektorin e Kontrollit, pasi që këto pozita do të ndikonin drejtpërsëdrejti në mbarëvajtjen e punës së Sektorit si dhe do të ndikonin në rritjen e mbikëqyrjes së plotësimin të dosjeve për vendimet e shqiptimit të gjobave dhe cilësisë së raporteve të inspektimeve.	Pajtohem	Dhjetor 2015
2.	IPK rekomandon menaxhmentin e DMH-së, që në afat sa ma të shkurtër kohor të bëjë azhurnimin e Procedurave Standarde të Sektorit të Kontrollit dhe Sektorit të Deportimeve, në mënyrë që këto Procedura Standarde të Operimit të jenë në harmoni me ligjin e ri Nr.04/L-219 Për të Huaj.	Pajtohem	Janar 2016
3.	IPK rekomandon menaxhmentin e DMH-së, që në bashkëpunim me Drejtorinë për Teknologji Informativë t'i shqyrtoj mundësitë e krijimit të një baze të të dhënave të përbashkët për të gjitha aktivitetet e DMH-së, si dhe krijimi i kësaj baze të të dhënave të jetë në njërin prej programeve të posaçme për krijimin e bazave të të dhënave.	Pajtohem	Ne Dhjetor 2015 do të ngritet kërkesa ne DTI.
4.	IPK rekomandon menaxhmentin e DMH-së që përmes hierarkisë mbikëqyrëse/ gradave gjegjëse të shtoj kontrollin tek zyrtarët policor sa i përket plotësimin të dosjeve fizike me kopjet e dokumenteve të parapara sipas Procedurës Standarde të Operimit për Zbatimin e Dispozitave Ndëshkimore nga Ligji për të Huaj.	Pajtohem	Menjëherë dhe ne vazhdimësi
5.	IPK rekomandon menaxhmentin e DMH-së që të angazhohet më shumë në zbatimin e Kreut X "Dispozita Ndëshkimore", të Ligjit për të Huaj, në mënyrë që të shmangët mospërputhja e numrit të personave të gjetur në shkelje të Ligjit për të Huaj dhe personave ndaj të cilëve janë ndërmarrë masat ndëshkimore.	Pajtohem	Menjëherë dhe ne vazhdimësi
6.	IPK rekomandon menaxhmentin e DMH që përmes hierarkisë mbikëqyrëse/ gradave gjegjëse të shtoj kontrollin e cilësisë së raporteve të inspektimeve, në mënyrë që në të ardhmen këto raporte të jenë më të pajisura më të dhëna nga të gjeturat e inspektimit si dhe të shmangen nga gabimet teknike gjatë përpilimit të raporteve.	Pajtohem	Menjëherë dhe ne vazhdimësi